

Syllabusi i lëndës

Lënda: AKAID III – *Sektet dhe shkollat islame*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 308

Fondi i orëve: 3+3

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: VI

Mësimdhënësi: Prof. ass. dr. Zija Abdullahu Kontakti: e-maili: zabdullai@hotmail.com

Përshkrim i shkurtër i lëndës

Studimi përfshinë sektet më të rëndësishme gjatë historisë dhe ato aktuale në botën islame. Pjesën më të madhe ngërthen Shi-izmi, i cili është me shtrirje më të gjerë në botën islame, dhe nga i cili janë nën degëzuar shumë sekte tjera. Veçori të theksimit kanë sektet që gjenden në trojet tona me të cilat bashkëjetojmë, ato tradicionale dhe ato në shtrirje e sipër, qendrat, aktivitetin dhe shtrirjen e tyre. Të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet këtyre sekteve. Qëndrimi islam ndaj këtyre sekteve.

Qëllimi i lëndës

Njohja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Sekteve dhe Shkollave Islame, duke hulumtuar dhe studiuar sektet më të rëndësishme gjatë historisë dhe ato aktuale në botën islame. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e sekteve të ndryshme të cilat përfshin programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione për gabimet dhe sukseset që kanë korrur këto sekte gjatë historisë. Fitimi dhe avancimi i sensit të kritikës në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse të Islamit ndaj këtyre sekteve. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për to, në një stil të pastër dhe bindës të të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga lëmi i Sekteve dhe Shkollave Islame presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë njohuri të bollshme mbi sektet gjatë historisë dhe ato më dominuese në botën islame, e në veçanti njohuri për sektet që gjenden në trojet tona, me të cilat bashkëjetojmë, dhe t'i njohë të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet tyre. Të kuptojë proceset e zhvillimit që nga formimi i tyre e deri në ditët e sotme. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, t'i kuptoj se çështjet e përbashkëta që i afrojnë këto sektet janë më shumë se ato që i ndajnë. Të kuptojë se zhvillimi i sekteve në fe të ndryshme, në këtë rast edhe në atë Islame është një fenomen natyrorë, prandaj duhet të shërbej në ngritjen e tolerancës në

shoqëri, dhe se studimi i sekteve duhet të zhvillohet dhe të avancohet ditë e më shumë, mbase është në interes të bashkëjetesës dhe të paqes në rajon dhe në botë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të sekteve gjatë historisë si dhe ato më dominuese në botën islame.

Të krahasoj ndërmjet sekteve të ndryshme të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj në bazë të argumenteve të secilit sekt, duke qenë sa më objektiv në parashkrimin e tyre.

Të mbroj qëndrimet e secilë sekt, ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilit prej tyre, duke ia parashtruar argumenteve të shëndosha islame.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionet ndërsektare.

Metodologjia e mësimdhënies:

- Ligjërata
- Analiza dhe diskutime interaktive
- Prezantime të projekteve grupore dhe individuale
- Prezantimi i audio dhe video materialeve

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi. Shqyrtime të përgjithshme: Sektet si fenomen mbarë fetarë në fe të ndryshme. Kontributi i dijetarëve islam të mëhershëm për sektet dhe fraksionet islame. Mospajtimi si dukuri mbarnjëzore. Terminologjia: Fraksion, doktrinë, sekt, medh'heb, dhe shkollë. Mospajtimet ndërnjëzore. Bisedë interaktive, rreth shkakut më kryesorë dhe të më aktual të përçarjes ndërmjet muslimanëve.

Literatura: Dr. Zija Abdullahu, *Sektet dhe shkollat islame*, f. 3-11. (Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve).

Java e dytë: *Shkaqet e përgjithshme të mospajtimit ndërnjëzore:* Paqartësia e tematikave diskutuese. Fanatizmi në mendimet e trashëguara. Ndryshimi i kulturave dhe metodologjisë së studimit. Ambicet (dëshirat). Dashuria për pushtet dhe pozitë. *Shkaqet e veçanta të përçarjes ndërmjet muslimanëve:* fanatizmi ndër fisnorë, çështja e kalifatit, hyrja në Islam nga fetë tjera, ajetet

me më shumë kuptime (*muteshabihat*), përkthimi i librave filozofike, treguesit e përrallave (*israilijattet*), ndryshimet në shkollat juridike të fikhut. Bisedë interaktive mbi shkaqet e tanishme të përçarjes.

Literatura: (f. 12-19).

Java e tretë: Manifestimi i përçarjes ndërmjet muslimanëve. Grupet politike. Qëndrimi i Kur'anit dhe Sunetit ndaj politikës apo halifatit: drejtësia, kuvendi konsultativ (*Shura*), respekti i të zgjedhurit.

Përsëritje nga orët e mëparshme

Literatura: (f. 20-24).

Java e katërt: Manifestimi praktik i përçarjes ndërmjet muslimanëve. Përçarja e muslimanëve rreth halifatit. Shkaqet e rebelimit në periudhën e h. Osmanit. Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura: (f. 25-32).

Java e pestë: Luftat nxitëse të shfaqjes së sekteve: Lufta e Devesë. Lufta e Sifinit. Paraqitja e sekteve në skenën shoqërore. Harixhitët. Debat rreth pasojave të luftërave ndër sektare në botën islame

Literatura: (f. 33 -40).

Java e gjashtë: Shi-izmi. Parimi kryesorë i shiizmit. Situata nën të cilën është formuar ky sekt. Vendbanimet e shiave. Faktorët nga të cilët janë ndikuar shiat. Bisedë interaktive, rreth ndikimeve të shiitëve nga situatat dhe trashëgimitë e mëparshme.

Literatura: (f. 41-47).

Java e shtatë: Shiitët ekstrem. Grupet e zhdukura të shiitëve ekstrem: Seb'itët, Gurabitët. Bejanitët. Mugiritët. Kisanijtë.

Testi i parë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit të parë

Literatura: (f. 44-60).

Java e tetë: Shiitët liberal (të rëndomtë). Zejditë: zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. Debat rreth afërsisë së tyre me *ehli sunetin*. Imamijtë\Ithnaasherijtë: zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale.

Bisedë interaktive mbi marrëdhëniet shiite-sunite në kohën bashkëkohore.

Literatura: (f. 61-67).

Java e nëntë: Grupet e shiitëve ekstreme ekzistuese: Imamijtë Ismailij - Batinijtë. Durzitët: zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale.

Bisedë interaktive, rreth krahasimit të shiitëve ekzistues ekstrem dhe liberal.

Literatura: (f. 68-72).

Java e dhjetë: Nusajritët/Alevitët. Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale.
Babizmi. Behaizmi. Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale.
Bisedë interaktive rreth krahasimit të botimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ahmedijë.

Literatura: (f. 70-75).

Java e njëmbëdhjetë: Babizmi. Behaizmi. Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. Ahmeditë/Kadianitë: Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale, dhe aktiviteti i tyre në trojet tona.
Debat mbi aktivitetin e Ahmedive në trojet tona.

Literatura: (f. 75-85).

Java e dymbëdhjetë: Manifestimi teorik i përçarjes ndërmjet muslimanëve. Murxhitët. Xhebrijtë. Kaderitë. Mu'tezilët: Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale.
Diskutime dhe përsëritje të leksioneve nga ora e mëparshme.

Literatura: (f. 86-95).

Java e trembëdhjetë: Maturiditë: Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale.
Selefizmi. Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale.
Bisedë interaktive për shkaqet e përhapjes të këtyre shkollave në trojet tona.

Literatura: (f. 96-107).

Java e katërbëdhjetë: Sufizmi dhe tarikatat në trojet tona: tarikati: Bektashi, Halveti, Kadiri, Rifai, Melemij, Mevlevij, Nakshibendijë.
Debat rreth kontributit të tarikateve në trojet tona.

Literatura: (f. 108-115).

Java e pesëmbëdhjetë: Qëndrimi islam ndaj tarikateve.
Testi përfundimtarë, studentët ndahen në dy grupe dhe i nënshtrohen testit me shkrim.

Literatura: (f. 115-120).

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Dr. Zija Abdullahu, *Sektet dhe shkollat islame*, Dispensë për vitin e tretë (për përdorim vetëm të brendshëm), Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2007.

Literatura konsultive:

1. Murtezai, dr. Ekrem; “*Fjalor i feve*”, Prishtinë, 2000
2. Topaloglu, dr. Bekir; “*Hyrje në kelam*”, përkth. Mit’hat Hoxha, Prishtinë, 2002
3. Tërnavë, Naim; “*Frakcionet në Islam*”, Prishtinë, 1997
4. Rexhepagiqi, Jashar; “*Dervishët dhe teqet*”, Pejë, 2003